

VENDIM
Nr.175, datë 25.3.2005

**PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË UJËSJELLËSVE NDAJ
KESH, SHA-SË, DHE TË TRETËVE, PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit t'i shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve të ujësjellësve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndërmarrjet e ujësjellësve të shlyejnë detyrimet ndaj KESH, sha-së, në shumën prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, dhe ndaj ARMO, sha-së, në shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh.

3. KESH, sh.a. të shlyejë detyrimet ndaj ARMO, sha-së, në shumën 300 000 000 (treqind milionë) lekë.

4. ARMO, sh.a. të shlyejë detyrimet ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në shumën 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në shumën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, dhe ndaj Albpetrolit, në shumën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë.

5. Albpetroli të shlyejë detyrimin ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në shumën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë.

6. Fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, që do t'i shtohet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, të përballohet nga fondi i kontingjencës, i vitit 2005.

7. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Financave dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano